

Në bazë të nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.58/00, 44/02, 82/08, 167/10 dhe 51/11 dhe „Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” 96/19 dhe 110/19), si dhe në bazë të nenit 22 dhe nenit 25 të Ligji për arsim të mesëm („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 44/1995, 24/1996, 34/1996, 35/1997, 82/1999, 29/2002, 40/2003, 42/2003, 67/2004, 55/2005, 113/2005, 35/2006, 30/2007, 49/2007, 81/2008, 92/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015, 30/2016, 127/2016, 67/2017 dhe 64/18)), ministri i Arsimit dhe Shkencës miratoi program të shkurtuar mësimor në lëndën **gjuhë gjermane** (gjuhë e dytë e huaj) për **vitin IV** të arsimit të mesëm katërvjeçar për vitin shkollorë 2020/21

**Program i shkurtuar
mësimor**



**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT**

GJUHË GJERMANE

viti i IV

Shkup 2020

arsimi i mesëm katërvjeçar

Hyrje

Planprogrami i shkurtuar mësimor për lëndën **gjuhë gjermane (gjuha e dytë e huaj)** bazohet në qëllimet e parashikuara me programin mësimor për këtë lëndë që zbatohet rregullisht në përputhje me programin e përcaktuar mësimor.

Programi i shkurtuar përcakton komponentet e caktuara dhe njësitë mësimore që duhet të realizohen për 145 ditë mësimore, duke respektuar fondin javor të përcaktuar në programin e rregullt, 2 orë në javë, pra gjithësej 58 orë.

Mësimdhënësi gjatë planifikimit dhe realizimit të njësive mësimore nga programi i shkurtuar udhëhiqet nga qëllimet, përmbajtjet, metodat dhe aktivitetet e përcaktuara në programin e rregullt mësimor.

1. Pasqyrë e komponentëve dhe aftësive gjuhësore¹

Komponenta e 1. Njësi leksikore

Komponenta e 2. Struktura gramatikore

Komponenta e 3. Funksione gjuhësore

Komponenta e 4. Dëgjim me kuptim

Komponenta e 5. Të shprehurit gojor

Komponenta e 6. Lexim me kuptim

Komponenta e 7. Të shkruarit

Komponenta e 8. Kulturë

2. Rekomandime didaktike

Qëllimi i këtyre rekomandimeve didaktike është që t'i ndihmojë mësimdhënësit që t'i arrijnë qëllimet e parashtruara në programin e rregullt mësimorë për vitin IV (e katërt) nga arsimi i mesëm katërvjeçar, me ndihmën e këtij programi të shkurtuar, i cili do të jetë udhërrëfyes për elementet më të rëndësishme që duhet të përfshihen. Baza fillestare për realizimin e këtij programi të shkurtuar mësimorë nga lënda mësimore gjuhë gjermane (gjuhë e huaj e dytë) është programi i rregullt mësimorë (qëllimet, përmbajtjet, shembujt, metodat dhe aktivitetet).

¹Në lidhje me komponentët e dhëna dhe fondi i ofruar i orëve me planprogramin e shkurtuar mësimor, mësimdhënësi bën një vlerësim të mënyrës dhe thellësisë së përpunimit të secilës komponent individualisht, duke marrë parasysh qasjen e integruar dhe të balansuar në mësimin e të gjitha elementeve gjuhësore.

Programi mësimor në parim nënkupton zhvillim të plotë dhe kompleks gjuhësor dhe komunikues përmes situatave konkrete dhe të ndërlidhura me veprim të të nxënësve. Kompetencat nuk zhvillohen individualisht dhe në mënyrë të veçantë, por duhet të krijohen mundësi të ndërlidhura, të gjithanshme të të mësuarit, të përshtatshme për moshën e nxënësve, përmes aktiviteteve të jetës të lidhura dhe nga ana funksionale përkatëse.

Aktivitetet e mësimdhënies duhet t'i integrojnë dhe lidhin kompetencat me qëllime të qarta tematike dhe detyra transparente për nxënësit. Mësimi i gjuhës gjermane për nxënësit e kësaj moshë bazohet në të mësuarit interaktiv që përfshin aspektet kognitive, afektive dhe motorike të nxënësve, domethënë mësuesi integron komponentet e ndryshme për mësimin funksional të gjuhës me një orientim të nevojës, aksionit, veprimit dhe komunikimit, zhvillimit të kompetencave kryesore, sensibilizimi për sjellje të pavarur dhe të përgjegjshëm të nxënësve, sensibilizimi i aspekteve ndërkulturore ku roli i mësuesve përfshin edhe rolin e moderatorëve, ndihmësve dhe partnerëve.

Mësimdhënia për këtë grup moshë është e orientuar drejt mëimit kognitiv me zbatim të vetëdijshëm të strukturave gjuhësore në kontekst dhe prezantim strukturor të strukturave gramatikore që studiohen në mënyrë të integruar, a jo si aftësi e veçantë gjuhësore. Gjatë kësaj periudhe, bëhen përpjekje për të zhvilluar komunikimin e të folurit dhe të shkruarit.

Kjo do të thotë që vëmendje e njëjtë iu kushtohet të gjitha aftësive gjuhësore: dëgjim dhe lexim në kuadër të komponentit të të kuptuarit, të shprehurit dhe të shkruarit, si në aspektin e interaksionit, edhe nga aspekti i prodhimit të pavarur.

Mësuesi duhet të nxisë dhe të zhvillojë autonominë e nxënësve përmes aktiviteteve dhe detyrave që u mundësojnë atyre që të marrin përgjegjësi për të nxënës, njohuritë dhe aftësitë që ata fitojnë në një kontekst formal të të mësuarit (në klasë) dhe i përdorin ato jashtë saj. Mësimi duhet të përfshijë aktivitete për zhvillimin e përdorimit të vetëdijshëm të njohurive të fituara dhe aftësitë nga gjuha e parë e huaj (gjuhë angleze) të përdorura në mësimin e gjermanishtes.

Duhet të përshtaten ose adaptohen aktivitetet që i përshtaten stileve të ndryshme të të nxënësve, lloje të ndryshme të inteligjencës dhe nivele të ndryshme të njohurive të nxënësve duke ndryshuar format e ndryshme të punës dhe sekuencat e veprimit. Në përputhje me këtë që u tha më lartë, në gjuhën e huaj nuk mund të ndahen, d.m.th. nuk mund të planifikohet numri i orëve për komponentet individuale. Mësimi i një gjuhe të huaj në secilën orë mësimore integron të gjitha aftësitë gjuhësore dhe komponentet.

Rekomandohet, në kuadër të komponentëve të dhëna si bazë të programit mësimor, dhe duke marrë parasysh numrin e përgjithshëm të orëve të parashikuara nga programi mësimor, komponentët e gjuhës (funksione gjuhësore, njësitë leksikore, strukturat gramatikore dhe përmbajtja ndërkulturore) dhe aftësitë gjuhësore (të dëgjuarit dhe të lexuarit me kuptim, të folurit dhe të shkruarit) të përvetësohen në mënyrë të integruar. E detyrueshme është të

përvetësohen të gjitha strukturat e parashikuara gramatikore, njësitë leksikore dhe funksionet gjuhësore me programin e rregullt mësimor. Rekomandohet që strukturat e reja gramatikore të bashkohen duke ushtruar me strukturat veç më të adaptuara gramatikore. Orët e parapara me programin e rregullt mësimor për përforcimin e përmbajtjeve mësimore (të mësuara) të reduktohen ndërsa aktivitetet të jenë të integruara në orët e parapara për përmbajtjet e reja mësimore. Në aspektin e metodave dhe aktiviteteve propozohet reduktimi i tyre ose zgjedhje e metodave ose aktiviteteve më efektive për përvetësimin e njesisë së dhënë dhe akomodimi i kohezgjatjes së orës mësimore për 35 minuta.

Duhet të theksohet se në këtë program të shkurtuar mësimor nga gjuha gjermane, numri i dhënë i orëve në tema të caktuara mundet të ndërrohet, apo i jepet liri arsimtarit për mënyrën e organizimit të mësimin dhe orëve, nëpërmjet lidhjes së asaj që është mësuar më parë, si dhe bashkimin e njësive mësimore .

3. Normativi për kuadrin mësimor

Programin e shkurtuar mësimor e realizon arsimtari në përputhje me normën për kuadrin mësimor të dhënë në programin e rregullt mësimor.

Programin e shkurtuar mësimor nga lënda mësimore **gjuhë gjermane** (gjuha e dytë e huaj) për **vitin IV** të arsimit të mesëm katërvjeçar e verifikoi

Ministri i Arsimit dhe Shkencës

Milla Carovska
